



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Boshllëqet informative dhe ndikimi i tyre në zgjedhje Perspektiva globale me përqendrim në Maqedoninë e Veriut

Nëntor 2024

Zbatuar nga:



International Foundation
for Electoral Systems

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
<i>Paqyrë e boshllëqeve informative</i>	3
2. Konteksti global: Rritja e boshllëqeve informative	3
3. Ballkani Perëndimor: Boshllëqet informative dhe manipulimi politik	4
<i>Peizazhi mediatik në Ballkanin Perëndimor</i>	4
<i>Erozioni i gazetarisë vendore</i>	5
<i>Pasojat për zgjedhjet.....</i>	Error! Bookmark not defined.
4. Rast studimor: Boshllëqet informative të Maqedonisë së Veriut	5
<i>Peizazhi mediatik në Maqedoninë e Veriut</i>	5
<i>Ndikimi i boshllëqeve informative në zgjedhje</i>	6
5. Trajtimi i boshllëqeve informative: zgjidhjet dhe sfidat	7
<i>Zgjidhjet globale dhe rajonale</i>	7
<i>Forcimi i gazetarisë vendore përmes granteve, trajnimeve dhe modeleve të reja të biznesit.....</i>	7
<i>Iniciativat bashkëpunuese të gazetarisë.....</i>	Error! Bookmark not defined.
<i>Programet e arsimit mediatik për fuqizimin e qytetarëve dhe reduktimin e dezinformacionit</i>	Error! Bookmark not defined.
<i>Përpjekjet specifike në Ballkanin Perëndimor dhe në Maqedoninë e Veriut për përmirësimin e gazetarisë hulumtuese</i>	8
6. Konkluzionet dhe rekomandimet	9
<i>Rekomandimet</i>	9
Bibliografia / Referencat	11

1. Hyrje

Pasqyrë e boshllëqeve informative

Boshllëqet informative janë zonat ku qasja në lajme të ndryshme, të besueshme dhe të pavarura është e kufizuar, veçanërisht në nivelin vendor. Në përgjithësi, këto rajone shpesh nuk kanë media informative, me burime për gazetari hulumtuese dhe informim objektiv, duke i lënë bashkësitë pa informacion thelbësor. Faktorë të tillë si kolapsi i industrive vendore informative, përqendrimi i pronësisë së mediave, presioni politik dhe rritja e platformave digjitale kontribuojnë në këto boshllëqe.

Informacioni i besueshëm është thelbësor për angazhimin demokratik, duke mundësuar votim të informuar dhe llogaridhënie. Pa të, boshllëqet informative¹ krijojnë apatinë e votuesve, shpërndajnë dezinformacione dhe mundësojnë që korrupsioni të mos kontrollohet. Ky punim hulumton mënyrën se si këto boshllëqe ndikojnë në zgjedhje, duke u përqendruar në Ballkanin Perëndimor, me Maqedoninë e Veriut si rast studimi. Në të shqyrtohen sfidat rajonale, roli i kapjes së mediave dhe zgjidhjet e mundshme për nxitjen e pjesëmarrjes së informuar demokratike.

2. Konteksti global: Rritja e boshllëqeve informative

Boshllëqet informative shpërndahen globalisht si burime vendore informative meqë bien nën ndikimin ekonomik, transformimin digjital dhe pronësinë e përqendruar të medias. Mediat tradicionale, siç janë gazetatat dhe radiot vendore po mbyllen, për shkak të rënies së të ardhurave nga reklamat dhe konkurrenca e platformave të mëdha digjitale si Meta dhe Google, të cilat i japin përparësi përmbajtjes kombëtare dhe sensacionale. Rrjedhimisht, bashkësitë e rajoneve të ndryshme—nga Amerika rurale deri te pjesët e Afrikës, Azisë dhe Evropës—kanë qasje të pakët në informimin e besueshëm të nivelit vendor.

Kjo rënie në gazetarinë vendore ndikon në zgjedhjet duke ua mohuar votuesve informacionin e nevojshëm për të bërë zgjedhje të informuara, veçanërisht në garat vendore që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjeve të bashkësisë. Mungesa e gazetarisë vendore mbikëqyrëse gjithashtu e zvogëlon përgjegjësinë, duke lejuar që dezinformacioni të mbushë zbrazëtirën dhe të krijojë polaritet në bashkësi.

Vështirësitë ekonomike me të cilat përballen mediat vendore përkeqësohen nga ndikimi i konglomeratëve të mëdhenj mediatikë, të cilët shpesh i blejnë mediat që hasin në vështirësi dhe e zhvendosin fokusin në rrëfimet e gjera dhe fitimprurëse në llogari të mbulimit mediatik vendor. Si plotësim, platformat digjitale i monopolizojnë të ardhurat e reklamave, duke i lënë mediat vendore me mjete financiare të pamjaftueshme për të mbështetur informimin e pavarur.

Ndikimi politik e rrënon më tej gazetarinë e pavarur, meqenëse elitat i kontrollojnë ose i financojnë mediat që të formësojnë opinionin publik ose të shtypin mospajtimin. Ky ndikim shprehet veçanërisht në nivelin vendor, ku mediat e financuara me mjete publike shpesh kanë mungesë burimesh dhe i nënshtrohen kontrollit politik. Gazetarët ballafaqohen me presionin

¹ Boshllëku informativ është zonë gjeografike ose sociale ku banorët kanë qasje të kufizuar në burimet me lajme të besueshme, të llojllojshme dhe të pavarura. Në këto zona, gazetaria vendore shpesh mungon ose ka burime të pamjaftueshme, duke i lënë bashkësitë pa informacionin thelbësor për qeverisjen vendore, çështjet publike dhe brengat specifike të bashkësisë.

për të shmangur informimin kritik, i cili ngulfat informimin kritik, gërryen besimin te mediat, dhe ngushtëson shumëllojshmërinë e perspektivave.

Boshllëku informativ krijon apatinë dhe keqinformimin e votuesve, duke ndikuar në angazhimin demokratik në mbarë botën. Mbyllja e mbi 2,000 gazetave në SHBA që nga viti 2004 i ka lënë shumë zona rurale pa lajme vendore, duke krijuar terren pjellor për dezinformacionin, veçanërisht në mediat sociale.² Gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020 në SHBA, pretendimet e pambështetura për votimin me postë çuan në mosbesim të gjerë në integritetin e zgjedhjeve, duke kontribuar në ndarjet partiake dhe dyshimet e kamotshme për institucionet demokratike. Është e rëndësishme se gjatë vitit 2024, personalitet e shquara të cilat e shpërndanë këtë dezinformacion, siç është Donald Trump-i, e zhvendosën atë për të nxitur të gjitha metodat e votimit të hershëm, duke theksuar ndikimin e narrativëve të rinj.³ Kjo prire ilustron mënyrën se si bashkësitë e privuara nga lajmet e besueshme vendore mbeten të rrezikuara nga ndryshimi i narrativëve të rremë që mund të shtrembërojnë rezultatin e zgjedhjeve dhe të dobësojnë demokracinë.

3. Ballkani Perëndimor: Boshllëqet informative dhe manipulimi politik

Peizazhi mediatik në Ballkanin Perëndimor

Peizazhi mediatik në Ballkanin Perëndimor formësohet nga pronësia e përqendruar, ndikimi thelbësor politik dhe themelet e paqëndrueshme ekonomike, veçanërisht për mediat vendore.⁴ Në mbarë vendet si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, disa grupe të fuqishme mediatike—shpesh në pronësi të familjeve ose bizneseve të lidhura politikisht—dominojnë tregun. Këta konglomeratë kontrollojnë një pjesë të konsiderueshme të mediave televizive dhe të shtypit, duke kufizuar larminë e perspektivave dhe zërave. Ndërkohë, mediat vendore dhe të pavarura përballen me kufizime të rënda burimesh, duke u mbështetur në të ardhurat e kufizuara nga reklamat dhe në mbështetjen e pamjaftueshme financiare për të konkurruar me firmat e mëdha mediatike të lidhura politikisht.

Oligarkët dhe aktorët politikë luajnë rol kryesor në formësimin e narrativëve mediatikë, shpesh duke përdorur aksione pronësore ose ndikim financiar për të çuar përpara programet e tyre. Individët e pasur dhe grupet me ndikim politik i zotërojnë ose i financojnë mediat kryesore, duke e drejtuar përmbajtjen për mbështetjen e interesave të tyre, ndërkohë duke shtypur këndvështrimet kritike. Këta aktorë shpesh përdorin taktika juridike—siç janë paditë strategjike ndaj gazetarëve (SLAPP) dhe ligjet për shpifje—për të frikësuar dhe heshtur informimin e pafavorshëm.

² Abernathy, Penelope Muse. *Boshllëqet e lajmeve dhe gazetave fantazma: A do të mbijetojnë lajmet vendore? Qendra për inovacion dhe qëndrueshmëri në mediat lokale, Shkolla e Husmanit e gazetarisë dhe medias, Universiteti i Karolinës së Veriut në Chapel Hill, 2020. Në dispozicion në usnewsdeserts.com për një hartë interaktive dhe burime plotësuese.*

³ Dewey, Caitlin. "Trump-i dikur e quajti votimin e hershëm një "mashttrim". Por, tani planifikon ta bëjë vetë." *Vanity Fair*, 23 tetor 2024, <https://www.vanityfair.com/news/story/trump-plans-to-vote-early-himself-after-maligning-the-practice-for-years>.

⁴ Media vendore është organizatë mediatike që prodhon përmbajtje të përshtatura në mënyrë specifike për një zonë ose bashkësi të caktuar gjeografike, duke u fokusuar në çështje, ngjarje dhe shqetësime që prekin drejtpërdrejt banorët e saj. Mediat vendore luajnë një rol vendimtar në informimin e qytetarëve për tema specifike të bashkësisë, siç janë pushteti vendor, arsimi, shëndetësia dhe çështje të tjera publike, për të cilat shpesh njoftohet në mënyrë të pamjaftueshme nga mediat kombëtare.

Radiodifuzerët publikë dhe rregullatorët mediatikë, të cilët obligohen ligjërisht të jenë të paanshëm, shpeshherë anojnë kah interesat politikë, duke i përforcuar programet shtetërore dhe partiake në informimin e tyre. Ky mjedis jo vetëm që mënjanon gazetarinë e pavarur, por edhe inkurajon autocensurën, meqë frika nga hakmarrja ngulfat informimin hulumtues dhe kufizon qasjen e publikut për informim të paanshëm në mbarë rajonin.

Erozioni i gazetarisë vendore

Kriza financiare e vitit 2008 bëri që të tërhiqen fondet e huaja, duke i hapur dyert për bizneset e lidhura politikisht me qëllim që të ndikohet në përmbajtjen mediatike. Rrjedha e të ardhurave të kufizuara i detyroi shumë media vendore që të mbështeten në përmbajtjen e paracaktuar ose në njoftimet për shtyp të qeverisë, të cilave u mungonin burimet e informimit burimor për problemet e rëndësishme vendore.

Kjo ngarkesë ekonomike rezulton në mbulimin minimal të qeverisjes vendore, të infrastrukturës dhe të korrupsionit — fushat kryesore për përgjegjësinë e bashkësisë. Në Malin e Zi, për shembull, mediat vendore shpeshherë u shmangen temave kontroverse për të parandaluar shkurtimin e financave ose hakmarrjen politike, duke e lënë publikun e painformuar lidhur me vendimet të cilat ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Peizazhi i pasigurt financiar dhe politik i gazetarisë vendore në Ballkan në këtë mënyrë e vazhdon ciklin e informimit të pamjaftueshëm dhe mungesën e transparencës, duke dobësuar angazhimin demokratik në nivelin e bashkësisë.

Pasojat për zgjedhjet

Erozioni i gazetarisë së pavarur në Ballkanin Perëndimor ndikon seriozisht në zgjedhjet, veçanërisht në nivelin lokal. Nëse nuk ekziston qasja në informacionin e besueshëm lidhur me qeverisjen, infrastrukturën dhe korrupsionin, votuesit nuk kanë vetëdije për problemet që prekin bashkësitë e tyre, që shpie në mosangazhim dhe dalje të ulët.

Këto vështirësi intensifikohen nga shpërndarja e dezinformacionit, shpesh në vija etnike dhe nacionaliste. Retorika nacionaliste dominon në narrativët mediatikë, duke i lënë mënjanë shqetësimet e bashkësisë dhe duke nxitur ndarje. Aktorët politikë i shfrytëzojnë këto dinamika, duke i përdorur platformat mediatike për të forcuar narrativët përçarës, në vend se të nxisin debat konstruktiv për problemet e bashkësisë. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, për shembull, informimi mediatik shpesh përqendrohet në identitetin etnik, në vend se në temat aktuale të qeverisë ose në temat ekonomike, duke nxitur polarizim dhe duke reduktuar llogaridhënien në qeverisjen vendore. Klima e dezinformimit dhe e anësisë etnike e rrënon pjesëmarrjen demokratike dhe i parandalon votuesit për të bërë zgjidhje të informuara.

4. Rast studimor: Boshllëqet informative të Maqedonisë së Veriut

Peizazhi mediatik në Maqedoninë e Veriut

Përqendrimi i madh i mediave në kryeqytetin e Shkupit dhe numri i pakët i mediave vendore në qytetet më të vogla e karakterizojnë peizazhin mediatik të Maqedonisë së Veriut. Ky centralizim rezulton në qasjen e kufizuar të lajmeve relevante vendore për banorët jashtë kryeqytetit.

Tregu mediatik në Maqedoninë e Veriut është i fragmentuar, me një numër të konsiderueshëm mediash të cilat garojnë për të ardhura të kufizuara nga reklamat. Kjo ngarkesë ekonomike prek në mënyrë joproporcionale mediat vendore, të cilat hasin në vështirësi në mbarëvajtjen e punës për shkak të audiencave të tyre të vogla dhe burimeve të reduktuara financiare. Rrjedhimisht,

shumë media lokale nuk kanë burime të mjaftueshme, duke çuar në rënien e cilësisë dhe sasisë së informimit vendor.

Përkatësitë politike ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në përmbajtjen mediatike dhe në praktikën e informimit. Partitë kryesore politike kanë krijuar marrëdhënie me mediat e caktuara, gjë që çon në informimin e anshëm i cili i favorizon programet e tyre politike. Ky përafrim shpesh rezulton në përfaqësimin e pamjaftueshëm të pikëpamjeve alternative dhe mungesën e gazetarisë kritike, veçanërisht në lidhje me qeverisjen vendore.

Përqendrimi i pronësisë së medias i përkeqëson më tej këto vështirësi. Disa individë ose subjekte i kontrollojnë mediat e shumta, që kufizojnë pluralizmin mediatik dhe shumëllojshmërinë e perspektivave.

Ndikimi i boshllëqeve informative në zgjedhje

Boshllëqet informative kanë një ndikim të thellë mbi zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në rajonet rurale ku mediat janë në numër të vogël. Mungesa e informacionit relevant vendor kontribuon në angazhimin e ulët qytetar dhe në daljen e reduktuar të votuesve. Kjo tendencë ishte evidente në zgjedhjet lokale të vitit 2021, ku dalja e përgjithshme e votuesve në nivelin kombëtar ishte 51,44 %, por për komunat e caktuara rurale, siç janë Qendër Zhupë (25,78 %), Gostivar (39,02 %), Lipkovë (37,49 %), Mavrovë dhe Rostushë (32 %), Plasnicë (34,65 %) dhe Vrapçisht (36,15 %) u raportua për një dalje shumë të ulët.⁵ Hendeku ndërmjet zonave urbane dhe rurale në pikëpamje të qasjes mediatike do të thotë se ata që jetojnë jashtë qyteteve të mëdha kanë ekspozim të kufizuar të lajmeve lidhur me zgjedhjet.

Kjo mungesë e mediave lokale në zonat rurale bën që këto bashkësi të rrezikohen nga narrativët dezinformues dhe nacionalist të cilët i shfrytëzojnë ndarjet etnike, veçanërisht ndërmjet bashkësive maqedonase dhe shqiptare. Para zgjedhjeve të vitit 2024, u vërejt një rritje e dukshme e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformacionit në internet, ku caku i shumicës prej tyre ishin dallimet etnike dhe nderzja e tensioneve ekzistuese. Në zonat pa media vendore të fuqishme, këto mesazhe përçarëse mund të shpërndahen më lehtësisht, shpesh të pakontrolluara, duke formësuar perceptimet dhe duke ndikuar në sjelljen e votuesve bazuar në frikë ose ndarje.

Zgjidhja e boshllëqeve informative në Maqedoninë e Veriut është thelbësore për kultivimin e një trupi votues më të informuar dhe reduktimin e ndikimit të narrativëve të dëmshëm të cilët nxisin përçarje. Duke forcuar praninë e mediave vendore në zonat rurale së bashku me informimin objektiv dhe profesional, vendi mund të përmirësojë angazhimin e votuesve, të zvogëlojë përhapjen e dezinformacionit dhe të nxisë një proces zgjedhor i cili do ta pasqyrojë më mirë larminë e perspektivave dhe përkushtimin për një unitet social. Në një afat më të gjatë, zgjerimi i qasjes së informacionit të saktë dhe të paanshëm mund të ndihmojë që Maqedonia e Veriut t'i mposhtë forcat që momentalisht krijojnë polaritet dhe pengojnë qeverisjen e mirëfilltë përfaqësuese.

⁵ Në Qendër Zhupë dhe Mavrovë e Rostushë, zgjedhjet u shpallën të pavlefshme për shkak të daljes së pamjaftueshme të votuesve.

5. Trajtimi i boshllëqeve informative: zgjidhjet dhe sfidat

Zgjidhjet globale dhe rajonale

Zgjidhjet globale dhe rajonale për boshllëqet informative përqendrohen në rigjallërimin e gazetarisë vendore⁶, nxitjen e modeleve të qëndrueshme të biznesit, inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet mediave dhe përmirësimin e arsimimit mediatik për t'i fuqizuar qytetarët kundër dezinformacionit.⁷ Këto iniciativa janë domethënëse për rindërtimin e ekosistemeve vendore informative dhe sigurimin se bashkësitë, veçanërisht në boshllëqet e hapësirave informative, do të kenë qasje më të mirë në informacionin e besueshëm.

Forcimi i gazetarisë vendore përmes granteve, trajnimit dhe modeleve të reja të biznesit

Organizatave ndërkombëtare u kanë ofruar mbështetje mediave vendore informative që hasin në vështirësi. Këto mjete u ndihmojnë mediave që të mbijetojnë në zonat me vështirësi ekonomike, duke u mundësuar atyre që të informojnë mbi çështjet vendore. Një mbështetje e tillë i përfshiu edhe mjetet për projektet hulumtuese.

Programet e trajnimit janë po ashtu të rëndësishme për zhvillimin e gazetarisë vendore. OJQ-të dhe organizatat mediatike shpesh i financojnë këto programe, të cilat mësojnë për shkathhtësitë e informimit hulumtues, gazetarinë digjitale dhe standardet etike. Organizatat, siç janë Qendra Ndërkombëtare e Gazetarëve (ICFJ) dhe Qendra Evropiane e Gazetarisë (EJC) ofrojnë trajnim dhe mentorim të vlefshëm, veçanërisht në rajonet me burime të kufizuara, duke ndërtuar një forcë punuese të kualifikuar e cila është e aftë për të prodhuar informim të cilësisë së lartë dhe të pavarur.

U shfaqën edhe modele të reja biznesi, duke përfshirë gazetarinë jofitimprurëse⁸, duke u mbështetur në donacione, grante dhe anëtarësime, duke reduktuar varësinë nga reklamat. Gazetaria që mbështetet nga bashkësia, ku lexuesit kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes abonimeve ose donacioneve, është një opsion tjetër, siç është [ProPublica](#) në SHBA dhe organizata vendore jofitimprurëse, siç është [Mississippi Today](#) të cilat përqendrohen në gazetarinë e cilësisë së lartë hulumtuese dhe financohen nga lexuesit dhe grantet. Ky model nxit pavarësinë redaktoriale, duke i fuqizuar bashkësitë për t'i mbajtur burimet e veta të lajmeve.

Iniciativat bashkëpunuese të gazetarisë

Gazetaria bashkëpunuese u mundëson mediave të shumta vendore që të shkëmbejnë burime dhe ekspertiza dhe të mbulojnë së bashku çështjet që janë tepër komplekse ose që kërkojnë burime intensive për një medie. Me shoqërimin e burimeve, këto iniciativa përmirësojnë cilësinë e mbulimit dhe kapin një audiencë më të gjerë, madje në zonat me burime të kufizuara.

Projektet e bashkëpunimit, siç është hulumtimi i [Dokumenteve të Panamasë](#) tregon fuqinë e shkëmbimit të burimeve ndërmjet gazetarëve. Ndonëse këto projekte janë globale, ato frymëzojnë edhe bashkëpunime rajonale. Në Evropë, [Rrjeti ballkanik i gazetarisë hulumtuese](#)

⁶ Në këtë punim, gazetaria vendore ka për qëllim që të raportojë lajme dhe çështje relevante për një bashkësi të caktuar, duke mbuluar temat, siç janë qeverisja vendore, siguria publike dhe ngjarjet e bashkësisë. Ajo nxit angazhimin qytetar dhe llogaridhënien duke i informuar banorët për çështjet vendore dhe duke kërkuar përgjegjësi nga zyrtarët.

⁷

⁸ **Gazetaria jofitimprurëse** është model gazetarie i përdorur prej organizatave që i japin përparësi shërbimit publik, në vend të përfitimit. Këto organizata prodhojnë lajme dhe raportim hulumtues që financohen kryesisht përmes donacioneve, granteve dhe anëtarësimeve, në vend të të ardhurave nga reklamat.

(BIRN) lehtëson bashkëpunimin ndërmjet gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, duke mbuluar çështjet ndërkufitare, siç janë korrupsioni dhe politika e ambientit jetësor . Në Maqedoninë e Veriut, gazetaria bashkëpunuese i ka nxjerrë sheshit çështjet që nuk është raportuar mjaftueshëm për to, siç janë krimi i organizuar dhe vështirësitë ekonomike. Bashkëpunimet e këtilla e përforcojnë cilësinë e informimit dhe e zgjerojnë shtrirjen e rrëfimeve të rëndësishme, duke i bërë të qasshme për shumë qytetarë dhe duke e rritur vetëdijën publike.

Përpyekjet specifike në Ballkanin Perëndimor dhe në Maqedoninë e Veriut për përmirësimin e gazetarisë hulumtuese

BE ka rol udhëheqës në promovimin e gazetarisë së pavarur në mbarë Ballkanin Perëndimor. Duke njohur rëndësinë e shtypit të lirë për zhvillim demokratik dhe integrim evropian, BE-ja ka destinuar mjete dhe burime domethënëse për mbështetjen e pavarësisë së mediave në rajon. Këto përpjekje i përfshijnë mjetet e pakthyeshme që ndahen në mënyrë të veçantë për gazetarinë hulumtuese, programet e ndërtimit të kapaciteteve për redaksitë dhe iniciativat për trajnime të dedikuara për pajisjen e gazetarëve me shkathtësi kritike për prodhimin e informimit etik të cilësisë së lartë. Duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për organizatat mediatike, BE-ja ndihmon që të ekuilibrohet ndikimi i elitave politike dhe të reduktohet varësia e mediave vendore nga financimi i motivuar politikisht.

Edhe mbështetja e donatorëve të tjerë është gjithashtu mjaft e rëndësishme, e cila ofrohet përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Fondit Evropian për Demokraci (EED), të cilat sigurojnë fonde për t'u vendosur modelet e qëndrueshme financiare për gazetarinë vendore. Këto modele ofrojnë mbështetje të rëndësishme financiare për organizatat informative, të cilat, përndryshe, mund të detyrohen për t'i mbyllur ose komprometuar standardet e tyre redaktorialë, për shkak të kufizimeve financiare. Donatorët gjithashtu kanë financuar një numër projektsh mediatike në Maqedoninë e Veriut për të inkurajuar transparencën, integritetin e gazetarisë dhe pluralizmin mediatik. Në kuadrin e këtyre projekteve, OJQ-të shpeshherë bashkëpunojnë me mediat vendore për të siguruar trajnime mbi teknikat e hulumtimit dhe raportimit digjital, për t'i pajisur gazetarët me mjetet e duhura për informimin efektiv dhe të paanshëm. Partneritetet e këtilla janë jetike në ndërtimin e sektorit të qëndrueshëm mediatik i cili do t'u qëndrojë ballë si presionit politik, ashtu edhe atij financiar.

Siç është përmendur më lart, organizatat si BIRN-ja kanë luajtur po ashtu rol të rëndësishëm në promovimin e medias së pavarur dhe mbështetjes së gazetarëve në Ballkan. Ato ofrojnë burime, mundësi rrjetëzimi, dhe platforma për projekte të përbashkëta hulumtuese që zbulojnë çështjet ndërkufitare, siç janë korrupsioni, krimi i organizuar dhe degradimi i ambientit jetësor.

OJQ-të kanë rol kryesor në promovimin e arsimimit mediatik në mbarë Ballkanin Perëndimor, duke vërejtur se qytetarët e informuar dhe me mendim kritik janë të rëndësishëm për një demokraci të shëndoshë. Këto organizata bëjnë trajnime, seminare dhe programe të bashkësisë për t'i mësuar qytetarët sesi të vlerësojnë burimet e lajmeve, të njohin anshmërinë dhe të verifikojnë informacionin para se ta pranojnë atë si fakt. Në Maqedoninë e Veriut, për shembull, grupet e shoqërisë civile kanë bërë nisma me qëllim të edukimit të publikut mbi identifikimin dhe rezistimin e propagandës, si dhe dallimin e burimeve të besueshme të lajmeve nga ato të motivuara politikisht ose ato sensacionale. Ky përqendrim te arsimimi mediatik është veçanërisht i rëndësishëm në rajonet e ndjeshme ndaj dezinformimit dhe retorikës nacionaliste, ngase qytetarët me njohuri më të mëdha të dinamikës mediatike kanë më pak ka gjasa të bien viktimitë e narrativëve manipulues ose çorientues.

Përveç trajnimit dhe financimit, modelet e biznesit në zhvillim e sipër janë duke u hulumtuar në mbarë Ballkanin për të përmbajtur gazetarinë vendore në mesin e sfidave ekonomike. Financimi grupor, për shembull, po merr vrull si një mënyrë që bashkësitë t'i mbështesin mediat e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përmes kontributeve të vogla e të rregullta nga lexuesit, mediat mund të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme pavarësisht reklamimit ose financimit politik, duke ruajtur pavarësinë e tyre redaktoriale.

Së bashku, këto përpjekje në Ballkanin Perëndimor dhe në Maqedoninë e Veriut trajtojnë rritjen e boshllëqeve informative duke fuqizuar gazetarët dhe qytetarët. Mbështetja e BE-së, e donatorëve të tjerë dhe e OJQ-ve për gazetarinë e pavarur, në kombinim me modelet e financimit novator dhe programet bazë të arsimimit mediatic, krijon bazë për një media vendore më të qëndrueshme, më të pavarur dhe më të informuar. Këto nisma janë të rëndësishme për kultivimin e mjedisit demokratik në të cilin qytetarët mund të kenë qasje në informacionin e besueshëm dhe të angazhohen në mënyrë kuptimplote në proceset politike, duke i zvogëluar rreziqet e shoqëruara me ndikimin e pakontrolluar politik dhe keqinformimin.

6. Konkluzionet dhe rekomandimet

Rekomandimet

- Forcimi i gazetarisë vendore: Implementimi i granteve, i subvencioneve dhe i programeve të trajnimit për mediat vendore të stërngarkuara financiarisht. Nxitja e modeleve të qëndrueshme të biznesit, siç janë organizatat jofitimprurëse, gazetaria e mbështetur nga bashkësia dhe financimi grupor me qëllim që të reduktohet varësia nga financimi i ndikuar politikisht.
- Nxitja e iniciativave të gazetarisë bashkëpunuese: Promovimi i partneriteteve ndërmjet organizatave mediatike për të bashkuar burimet dhe për të përmirësuar cilësinë e mbulimit, veçanërisht mbi çështjet komplekse e pa informim të mjaftueshëm, për të forcuar vetëdijen dhe angazhimin e bashkësisë.
- Mbështetja ndërkombëtare dhe rajonale: Të shfrytëzohet mbështetja e BE-së, e donatorëve tjerë ndërkombëtarë dhe e OJQ-ve, për të forcuar gazetarinë e pavarur në Ballkanin Perëndimor. Të zgjerohen iniciativat të cilat promovojnë pluralizmin mediatic, transparencën dhe reformat rregullatorë, me qëllim që të mbrohet pavarësia redaktoriale.
- Zhvillimi i modeleve të qëndrueshme ekonomike për gazetarinë vendore: Në hulumtimet e ardhme duhet dhënë përparësi modeleve të realizueshme të biznesit, siç është gazetaria e mbështetur nga bashkësia dhe ajo jofitimprurëse, për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të mediave vendore, veçanërisht në hapësirën e boshllëqeve informative. Këto studime mund të ofrojnë udhëzime mbi kornizat ekonomike që mundësojnë gazetarinë vendore të përparojë e pavarur, madje në rajonet me vështirësi ekonomike.
- Vlerësimi dhe zgjerimi i programeve për arsimimin mediatic: Zbatimi i vlerësimeve rigorozet të iniciativave për arsimim mediatic për të përcaktuar praktikën më të mira për reduktimin e dezinformacionit dhe promovimin e qytetarisë së informuar. Në këtë

hulumtim duhet të shqyrtohet se si arsimimi mediatik mund të integrohet me efektivitet në planet mësimore shkollore dhe programet e bashkësisë, me qëllim që të nxitet një publik i angazhuar në mënyrë kritike.

- Zbatimi i intervenimeve politike dhe i zgjidhjeve teknologjike: Hulumtimi i kornizave politike që zbatojnë transparencë në pronësinë e mediave dhe kufizojnë monopolet politike, duke kultivuar pluralizmin mediatik. Si plotësim, hulumtimi i gazetarisë hulumtuese, modelet e financimit publik, dhe rolet e platformave digjitale mund t'i zbulojnë strategjitë e rritjes së financimit të pavarur politik, përmirësimin e raportimit hiper-vendor, dhe kërkesës për llogaridhënie të kompanive teknologjike. Së bashku, këto qasje synojnë kundërvënien e boshllëqeve të informacionit dhe mbështetjen e angazhimit demokratik në nivelin global.

Këto intervenime janë thelbësore për kundërvënien e boshllëqeve informative, duke siguruar qasjen e bashkësisë në informacionin e besueshëm dhe kultivimin e qëndrueshmërisë demokratike. Trajtimi i këtyre sfidave mund të krijojë një trup votues më të informuar, më të angazhuar dhe më të fuqizuar, që është thelbësor për progresin e shoqërive demokratike.

Mohim përgjegjësie: Ky studim është bërë në kuadër të Programit për mbështetjen e zgjedhjeve të Qeverisë së Zvicrës, të cilin e implementon Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES). Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë prezantim nuk reflektojnë domosdoshmërisht me ato të donatorit, të projektit apo të zbatuesit.

Bibliografia / Referencat

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Zgjedhjet vendore në Republikën e Shqipërisë më 14 maj 2023: Raport përfundimtar. OSBE, 29 shtator 2023, <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/553972.pdf>.

Komisioni Evropian. Raport për Shqipërinë 2024. Dokument pune i stafit të Komisionit, shoqëruar me Komunikatën mbi politikën e zgjerimit të BE-së 2024, SWD(2024) 690 final, 30 tetor 2024. Në dispozicion në [European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations](#).

Freedom House. “Shqipëria: Raport për vendin 2024 - Kombet në tranzicion.” *Kombet në tranzicion 2024*, Freedom House, 2024, <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2024>.

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Zgjedhjet e përgjithshme në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2 tetor 2022: Raport përfundimtar. OSBE, 2 shkurt 2023. Në dispozicion në https://www.osce.org/files/f/documents/0/2/536993_0.pdf.

Komisioni Evropian. Raport për Bosnjën dhe Hercegovinën 2024. Dokument pune i stafit të Komisionit, shoqëruar me Komunikatën mbi politikën e zgjerimit të BE-së 2024, SWD(2024) 691 final, 30 tetor 2024. Në dispozicion në [European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations](#).

Komisioni Evropian. Raport për Bosnjën dhe Hercegovinën 2024. Dokument pune i stafit të Komisionit, shoqëruar me Komunikatën mbi politikën e zgjerimit të BE-së 2024, SWD(2024) 691 final, mars 2024. Në dispozicion në [European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations](#).

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Mal të Zi, 11 qershor 2023: Raporti përfundimtar. OSBE, 11 dhjetor 2023. Në dispozicion në https://www.osce.org/files/f/documents/4/9/560256_1.pdf.

Komisioni Evropian. Raport për Malin e Zi 2024. Dokument pune i stafit të Komisionit, SWD (2024) 694 final, shoqëruar me Komunikatën mbi politikën e zgjerimit të BE-së 2024, 30 tetor 2024. Në dispozicion në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX%3A52024SC0694>.

Muk, Milena, dhe Marko Sošić. “Mali i Zi: Raport për vendin - Kombet në tranzicion 2024.” *Freedom House*, 2024.

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në Maqedoninë e Veriut, 24 prill dhe 8 maj 2024: Raport përfundimtar. OSBE, 2024. Në dispozicion në <https://www.osce.org/files/f/documents/5/e/576648.pdf>.

Komisioni Evropian. Raport për Maqedoninë e Veriut 2024. Dokument pune i stafit të Komisionit, shoqëruar me Komunikatën mbi politikën e zgjerimit të BE-së 2024, SWD(2024) [Numri i dokumentit], 30 tetor 2024. Në dispozicion në [European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations](#).

Vangelov, Ognen. “Maqedonia e Veriut: Raport për vendin 2024- Kombet në tranzicion.” *Freedom House*, 2024.

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Republikën e Serbisë, 17 dhjetor 2023: Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve. OSBE, 2024. Në dispozicion në https://www.osce.org/files/f/documents/1/3/563505_0.pdf.

Komisioni Evropian. Raport për Serbinë 2024. Dokument pune i stafit të Komisionit, shoqëruar me Komunikatën mbi politikën e zgjerimit të BE-së, SWD(2024) 695 final, 30 tetor 2024. Në dispozicion në [European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations](#).

Burazer, Nikola. “Sërbia: Raport për vendin 2024 - Kombet në tranzicion.” *Freedom House*, 2024.